



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:083780

Datë: 02.09.2024

Numri i dokumentit: 06113076

C.nr.1436/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarin Taulant Rexhëbeqaj, në çështje juridike kontestimore të paditësit: N.S. nga fshati Komuna e Prizrenit, me numër personal të cilin me autorizim e përfaqëson Av. D.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti: kompensim dëmi, jashtë seance, më datë 02.09.2024, mori këtë :

A K T G J Y K I M

-Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia-

REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit N.S. nga fshati Komuna e Prizrenit, me të cilën ka kërkuar që të “ *Aprovohet padia dhe kërkesë padia e paditësit N.S. nga fshati Komuna e Prizrenit, në tërësi si e bazuar obligohet e paditura Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” me seli në Prishtinë - që paditësit N.S. t’ia kompensojë dëmin material dhe jomaterial si pasojë e lëndimeve për të gjitha kategoritë e dëmit shumën prej 1.000,00 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë (dt. 22.04.2022), e deri në pagesën përfundimtare, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim, obligohet e paditura Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” me seli në Prishtinë që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm me përmbarim”*. **si e pabazuar.**

A r s y e t i m

Paditësi N.S. nga fshati Komuna e Prizrenit, përmes të autorizuarit të tij, av. D.M. nga Prizreni, me datën 26.04.2024, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “Dukagjini” me seli në Prishtinë, duke theksuar se me datë 07.04.2022, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, ku deri te aksidenti ka ardhur derisa vetura A, po qarkullonte në rrugën “....”, në drejtim të lagjes Petrovë dhe në momentin kur arrin tek rreth rrotullimi afër T-A, nuk përshtat shpejtësinë e lëvizjes para kyqjes në rreth rrotullim dhe e godet veturën B, të tipit “Daimler C220”, me targa të regjistrimit: ngjyrë hiri, viti i prodhimit: 2002.

Gjykata me aktvendimin C.nr.1436/2022 të datës 20.08.2024 ka ftuar paditësin N.S. që ta paguaj taksën gjyqësore.

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e datës 26.08.2024, për heqjen dorë nga kërkesëpadia, e njofton gjykatën se heq dorë nga kërkesëpadia, pasi që me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtë gjyqësore.

Me nenin 3 par. 1 të LPK-së është paraparë se *“Palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat juridiko – civile që i kanë parashtruar gjatë procedurës”*, ndërsa me par.2 të këtij neni është paraparë se *“Palët mund të heqin dorë nga kërkesat e tyre, ta njohin kërkesën e palës kundërshtare si dhe të bëjnë pajtim gjyqësor lidhur me kontestin e tyre”*.

Gjykata, pas heqjes dorë nga kërkesëpadia nga ana e paditësit, konstatoi se kërkesat janë të disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 149, paragrafit 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së) – me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadiës apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë)”* – pa shqyrtim të mëtejshëm vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Nga sa u tha më lartë, e bazuar në nenin 3 par. 1 dhe par. 2, lidhur me nenin 149 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1436/2022, datë 02.09.2024

G j y q t a r i

Taulant Rexhëbeqaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181, paragrafit 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se heqja dorë nga kërkesëpadia është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.